

I nderuar klient,

Ju falenderojmë që keni zgjedhur Raiffeisen Bank të jetë banka juaj.

1. Bazuar në nenin 8 të kontratës së Llogarisë Rrjedhëse, me anë të kësaj letre, Banka ju njofton për ndryshimin e disa prej komisioneve që aplikohen për produktet dhe shërbimet bankare, për tërheqjet dhe depozitime cash në degë (me rezervim ose pa rezervim) sipas tabelës më poshte, duke filluar nga **data 02 Shtator 2019**.

Komisionet e tërheqjeve cash

Shuma Monedhë LEK	Ishte	Bëhet	Shuma Monedhë e Huaj (MH)*	Ishte	Bëhet
Nga 0 deri në 50,000 LEK	50 LEK	150 LEK	Nga 0 deri në 300 MH	0 MH	1.5 MH
Nga 50,000.01 deri në 300,000 LEK	0 LEK	250 LEK	Nga 300.01 deri në 3,000 MH	0 MH	3 MH
Nga 300,000.01 deri në 500,000 LEK	0 LEK	500 LEK	Nga 3,000.01 deri në 3,800 MH	0 MH	5 MH
Nga 500,000.01 deri në 1,000,000 LEK	1% e shumës mbi 500,000 LEK	500 LEK	Nga 3,800.01 deri në 10,000 MH	1% e shumës mbi 3,800 MH	5 MH
Mbi 1,000,000.01		1,500 LEK	Mbi 10,000.01 MH		12MH

*Monedhë e Huaj (MH), i referohet të gjitha monedhave të huaja të cilat pranohen nga banka

Komisionet e depozitimeve cash

Shuma Monedhë LEK	Ishte	Bëhet	Shuma Monedhë e Huaj (MH)*	Ishte	Bëhet
Nga 0 deri në 50,000 LEK	0 LEK	100 LEK	Nga 0 deri në 300 MH	0 MH	1 MH
Nga 50,000.01 deri në 300,000 LEK	0 LEK	200 LEK	Nga 300.01 deri në 3,000 MH	0 MH	2 MH
Nga 300,000.01 deri në 1,000,000 LEK	0 LEK	400 LEK	Nga 3,000.01 deri në 10,000 MH	0 MH	4 MH
Mbi 1,000,000.01 LEK	0 LEK	1,200 LEK	Mbi 10,000.01 MH	0 MH	12 MH

*Monedhë e Huaj (MH), i referohet të gjitha monedhave të huaja të cilat pranohen nga banka

Ju ftojme të përdorni rrjetin më të madh të ATM-ve në Shqipëri, për kryerjen e veprimeve të tërheqjeve dhe depozitimeve cash. Gjithashtu mund të regjistroheni dhe të përdorni FALAS platformën digitale "Raiffeisen ON" për të kryer transfertat/pagesa falas apo me komision të reduktuar.

2. Në marrëveshjen mbi Përdorimin e Kartës Individuale të Kreditit, në listen e komisioneve të kartës së kreditit MasterCard, të përfshira në nenin "Ndryshimi i Kushteve të Punës", shtohet komisioni për veprime në ATM & POS jashtë vendit në monedhë të ndryshme nga monedha e kartës, duke filluar nga **data 02 Shtator 2019**.

Tabela e Komisioneve:

Seksioni D: Shërbime të tjera	
Komision për veprime në ATM & POS jashtë vendit në monedhe të ndryshme nga Karta	2% e shumës së veprimit

Për çdo informacion, jeni të lutur të vizitoni faqen tonë të internetit: www.raiffeisen.al ose degët e bankës.

Me respekt,

Raiffeisen Bank